



KOLEGJI AAB – PRISHTINE  
FAKULTETI EKONOMIK  
Dekanatit

**Programi për Studimet:** Master

**Emri i programit te Masterit:** Banka dhe Financa

**Lënda:** Kërkesë për lejimin e punimit te diplomës, tezat dhe projekt temën e masterit

**Kandidati:** Fëllënza Salihu nga Prishtina

**Titulli i Temës:** Kriza Globale Financiare dhe ndikimi i saj ne Kosove

**Propozimi për mentor:** Prof. Dr. Vjollca Hasani

**Përshkrimi i shkurtër i temës:**

Kriza e fundit financiare me efektet shkatërruese mbi ekonominë mbarëbotërore, pati fillet e saj në vitin 2007 dhe kulminacionin e arriti në Tetorë të vitit 2008.

Kjo krizë fillimisht goditi ekonominë amerikane, europiane dhe aziatike ,por u ndje edhe në gjith globin.

Gjatë vitit 2003 dhe 2004, Banka e Rezervave Federale Amerikane «Federal Reserve Bank» aplikonte përqindje të interesit tejet të ulët, për të stimuluar konsumin, për të nxitur familjet amerikane për të investuar në blerjen e shtëpive.

Mjaftoje që te shprehesh dëshirën e blerjes së shtëpisë edhe pa të ardhura mund të blije shtëpinë duke të akorduar kredinë edhe me 110% të vlerës reale të shtëpisë.

Këto kushte sollën edhe rritjen e kërkesave nga familjet për këto kredi dhe blerjen e shtëpive çka rrjedhimisht shkaktoj edhe rritjen e çmimeve të tregut të patundshmërive (objekteve), duke u rritur me 200%. U zhvillua një formë e njohur e financimit në Amerikë e ashtuquajtura «subprime» që nëse përkthehet në gjuhë shqipe do të thotë “kreditues në nënkategori”

Nga mos mundësia e kthimit te borxheve erdhi deri te nje çrregullim financiar qe per pasoje u shenderrua shume shpejte ne nje krize se pari kombetare e me pas duke kaluar edhe ne nderkombetare

E ndodhur përballë kesaj krize dhe recesionit që përfshiu ekonominë globale, ekonomia e Kosovës ka arritur t'i rezistojë valës së parë të krizës.

Efektet e krizes ekonomike globale jane ndier ne Kosove edhe forme te inflacionit vjetor mesatar ne vitin 2008 prej 9.3%, gje edhe e cila eshte pritur kur dihet se Kosova ka nje pjese te madhe te ushqimeve te importuara. Kjo vjen si pasoje e ngritjes se cmimeve ne nivel nderkombetar.